REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 927/20
Datë/Datum. 23.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Kreshnik Spahiu	13.11.2020	23.11.2020	927/20
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.11.2020, OE "PBC" Sh.P.K-Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër: 927/20, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) ku është rekomanduar për kontratë OE "DLD GROUP"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim i E-kioskut me pajisje përcjellëse" me numër të prokurimit: GRA618-20-4365-1-2-1, iniciuar nga AK – Kuvendi Komunal Graçanicë.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00 €.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

OE PBC parashtron se Autoriteti Kontraktues, me apo pa vetëdije, kërcënon të shkelë:

- Paragrafin 2 te Nenit 7 te Ligjit për Prokurim Publik ("LPP"); dhe
- Paragrafin 4 te Nenit 59 te LPP-se.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

HYRJE:

- OE PBC me 2 nëntor 2020, kishte parashtruar Kërkesë pre Rishqyrtim ndaj Njoftimit të AK me të cilin ishte shpallur fitues OE DLD Group Sh.P.K.

- Përkundër faktit se OE PBC në mënyrë shterruese i kishte bere kundërshtimet e tij ndaj Njoftimit te mësipërm, megjithatë, AK- ne mënyrë te paprecedentë, kishte vendosur që fare mos t'i trajtonte asnjërin

nga pretendimet e OE PBC. AK thjeshte mjaftohet me një arsyetim: "AK- KK i Graçanicës - Zyra e Prokurimit, ka vepruar sipas Vendimit të Organit Shqyrtues te Prokurimit nr: 709/20 të datës 27.10.2020.

- Ky arsyetim kaq i mangët - për OE "PBC"- është tërësisht jo-serioz, kur kihet parasysh fakti se i njëjti në mënyrë të qartë i kishte vënë në pah gjithë shkeljet që kishin quar në shpalljen e OE fitues. Andaj - pashmangshëm, OE PBC - detyrohet qe OSHP-se, t'i sjell ne vëmendje edhe njëherë gjithë shkeljet qe i kishin karakterizuar Njoftimin e datës 2 nëntor 2020. Ashtu qe - OE PBC, kërkon vëmendjen e OShP-se në këtë Ankese.

ARSYETIM

- OE PBC parashtronte se OE fitues - nuk i plotëson as për se afërmi specifikacionet teknike qe dalin nga Dosja e Tenderit.

- Kësisoj - Dosja e Tenderit ne Aneksin 1 - ne faqe 18 te saj, pika H, i cili flet lidhur me Ekioskun me pajisje përcjellëse me karakteristikat e saj, nder te tjera, parashtron:

"Pjesa e jashtme e-Kioskut duhet të jetë e përshtatur me ambientin e jashtëm dhe e përberë nga llamarina s'paku prej 4mm ne pjesën e përparme dhe se paku 2mm ne pjesën anësore. Gjate fazës se ofertimit, OE duhet te dorëzojë te paktën 1 mock-ups te detajuar me dimensione te e-Kioskut.

- Lidhur me këtë kërkesë ne Dosjen e Tenderit, OE i rekomanduar për Kontrate, ka dorëzuar disa fotografi te E-kioskave - pa dimensione, siç kërkohet ne Dosje te Tenderit. Pra nuk ka përmbushur kërkesat minimale te Dosje te Tenderit.

Provë:



- Me tutje, lidhur me kërkesën qe përmes fotografive te dëshmojë implementimin e te paktën tre (3) E-kiosqeve; këtë, OE i rekomanduar ka dështuar ta beje, për shkak se fare nuk i posedon te njëjtat. Ashtu qe, nuk do mend se nuk ka mundur as te përshkruaj vendin se ku janë implementuar ato. Pra nuk ka përmbushur

kërkesat minimale te Dosje te Tenderit.
Pra - OE i rekomanduar, nuk ofron fare zgjidhje lidhur me specifikacionet teknike që dalin nga Dosja e Tenderit. Kjo është shkelje e qartë e LPP-se nga ana e AK e cila te njëjtin e rekomandon për dhënie te Kontratës.

OE i rekomanduar, lidhur me kërkesat për specifikacione teknike, te njëjtat **vetëm i vulosë** - e qe edhe ky veprim si i tille bie ndesh me LPP-ne.

- OE PBC - po ashtu parashtron se, nga OE i rekomanduar fare nuk ka kërkuar sqarime shtesë, por te njëjtin, e ka shpallur fitues vetëm mbi bazën e Vendimit të OShP-se.

- OE PBC-parashtron se sot, me 2 nëntor 2020, është njoftuar nga AK, se OE i rekomanduar, ka bashkangjitur Broshurën e re, qe sipas tyre, i plotëson kërkesat qe dalin nga ky Aktivitet.

Ky veprim i AK - bie ndesh me dispozitat e LPP-se, për shkak se, AK, nuk mund te pranojë broshura *I* dokumentacione shtesë, nen arsyetimin se *"OE i rekomanduar gabimisht e ka ngarkuar broshurën e parë."* Këtë arsyetim AK nuk është dashtë ta pranoje si të mirëqenë dhe kësisoj të pranoje dokumentacione shtesë. Pavarësisht kësaj-nga një lexim i thjeshte i kësaj Broshure të re të bashkangjitur, vërehet se as kjo broshure nuk i plotëson kërkesat nga ky Aktivitet për shkak se e njëjta, dallimin e vetëm nga broshura e pare e ka se e njëjta është e vulosur.

- Ndonëse AK - gjate vlerësimit nuk do duhej ta mirrte për baze Broshurën e pare te ofruar nga OE i rekomanduar, sidoqoftë, edhe kjo Broshure si e tille, nuk i plotëson kërkesat qe dalin nga ky Aktivitet i Prokurimit. Kjo për arsyet si ne vijim:

- OE PBC Sh.P.K., parashtron se AK, ka shkelur paragrafin 2 te Nenit 7 te LPP-se për shkak se: nuk ka krijuar kushte për trajtim ne mënyrë te barabarte për Operatoret Ekonomike dhe ka vepruar ne mënyrë jo-transparente, duke e shpallur si tenderues te suksesshmen ofertuesin i cili ka përpiluar ofertën ne shpërputhje me kërkesat e njoftim për kontrate dhe dosjes se tenderit.

- OE PBC po ashtu konsideron se AK ka shkelur paragrafin 4 te nenit 59 te LPP-se, i cili parashtron: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve"

- Ndërkaq -AK- gjate vlerësimit te ofertave, ka vlerësuar site përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur, edhe pse, i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit për kërkesën A, konkretisht kërkesën për: CPU min. i5; Ram 8 GB; HDD-SSD min. 240 GB; portet e nevojshme për lidhje periferike rne e-IZioske dhe kërkesën për monitor (rezistent ndaj ujit); High Transparence; high precision and durability; Ports: USB antirust; anti-acid; anti-dust; Operating Temperature:-20 / + 50 oC;).

Provë:

A) PC Industrial - Industrial Mainboard: CPU Min i5; RAM: 8 GB; HDD-SSD: min 240 GB; dhe porti i nevojshëm për lidhje periferike me e-Kioskë. 17" Touch Screen (Rezistent ndaj ujit, High Transparence, high precision and durability;

Oferta nga OE i rekomanduar:

• PC industrial i mbrojtur me kuti metalike të veçantë
• Motherboard ASROCK H81M*DG4 – ose ekuivalent
• Processor INTEL Core i3 4170 BOX – ose ekuivalent
• RAM PC*12800, 4 GB, KINGSTON Value, DDR3 1600MHz – ose ekuivalent
• SSD 120 GB KINGSTON SATA3 – ose ekuivalent

• 22" Anti*Vandal Monitor dhe Touch screen, (Brightness: 260cd/m2; angle : horizontal 100°above, Vertical 80°aboveContrast: 450:1; Backlight tube life : more than 40,000hoursOperating temperature : *20*50oCResponse Time:16ms ; Dot pitch: 0.297 ; Max. resolution: 1280×1024)

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit për kërkesën B, konkretisht kërkesën për: 250 sheets + 2 x 500 sheets tray, 6 seconds, deri ne 1200 x 1200 dpi rezolucioni i printimit, 512 MB Memorie dhe 520MHz CPU, Minimum 3Kaseta.

Kërkesa B ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

B) A4 Laser Printer dhe Kaseta - Printer bardhë e zi - Kërkesat minimale: Deri në 30 ppm A4, 250 sheets + 2 x 500 sheets tray, 6 seconds, deri në 1200 x 1200 dpi rezolucioni i printimit, 512 MB Memorie dhe 520MHz CPU, Minimum 3 Kaseta.

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën B ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

• The Monochrome Laser printer with built*in single or duplexing offers the boost in performance and versatility, with high*speed printing as fast as 40 pages për minute, plus a flexible range of features and options.First page out as fast as 6.5 seconds thanks to the instant warm*up fuser • Paper Handling Standard:250*Sheet Input Tray.Starter Return Program Toner Cartridge 2,300 pages. • Options: 3,500*page

Toner Cartridge or 9,000 page High Yield Toner Cartridge

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit për kërkesën C, konkretisht kërkesën për: Print Speed: 150mm/s, Head temperature detection: Thermistor; Paper running out alarm; Paper to be run out alarm, Paper jam alarm; Interface:Serial Port/USB.

Provë:
Kërkesa C ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:
C) ThermalReceipt Printer - MS-D347 apo i ngjashëm - Thermal Printer, Letra (in-depth) 80mm, Dots/line:640 dots/line; Rezolucioni: 8; Print Speed: 150mm/s, Automaticcutter; Print width: 72 mm; Paper width: 80 mm; Thickness of paper: 56-150 μm; WxDxH (mm): Head temperature detection: Thermistor; Paper running out alarm; Paper to be run out alarm, Paper jam alarm; Interface:Serial Port/USB

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën C ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit për kërkesën D, konkretisht kërkesën për: Payout speed: 12 coins/s, duke mos ofruar/plotësuar Interfaced: USB Coin dimensions: Diameter: 18~28.5mm, Thickedss:1.65~3.2mm MCBF: 100,000

Provë:
Kërkesa D ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

D) SmartCoinDispenser - CoinAcceptor&SmartHopper apo i ngjashëm - Coin Acceptor and Payout speed: 12 coins/sSupport: euro coins 0.10, 0.20, 0.30, 0.50, 1:00, 2:00 Interfaced: USB Coin dimensions: Diameter: 18~28.5mm, Thickedss:1.65~3.2mm MCBF: 100,000

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën D ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:
• Coin Acceptor & Smart Hopper
• Coin Acceptor, Highest coin validation security using the unique MFT Multi*Frequency*Technology; Smart Hopper,mixed coin hopper & recycler, market leading coin capacity (1500 x €1)
• Pranon monedha metalike në EUR dhe kthen kusur kur vendoset vlera më e madhe 0.10, 0.20, 0.50, 1 DHE 2 EURO

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit për kërkesën E, konkretisht kërkesën për: skenim te dy llojeve te dokumenteve te identifikimit qe aplikohen ne Kosove.

Provë:

Kërkesa E ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

E) ID-Document Scaner – Skaneri duhet të skanojë të dy llojet e dokumenteve të identifikimit që aplikohen në Kosovë: skanimi i imazhit të dokumentit të identifikimit, leximi i dokumentit të identifikimit, dizajn për të mbrojtur dritën e diellit.

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën E ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

• ID dhe Passport Scanner me OCR Software,
• Passport dhe ID leximi,
• Rezolucioni i lartë i fotos 500 PPI me IR ndriçim të dukshëm të bardhë
• Glare*free imaging function për OCE efiqent dhe lexim të bar kodeve
• Leximi i barkodeve dhe realizimi shumë i shpejtë e shumë i saktë i OCR
• Përkrahje në zbulimin e dokumenteve të falsifikuara në rezolucion të lartë të imazhit bazuar në ndriçim të dukshëm të bardhë dhe IR ndriçim

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit për kërkesën E, konkretisht kërkesën për: 360 Night Vision Camera: IR Distance 1 Om, CMOS Sensor, Waterproof, SMP 1080P (Full-HD).

Provë:
Kërkesa F ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:
F) Kamera e integruar e sigurisë e jashtme – 360 Night Vision Camera: IR Distance 10m, CMOS Sensor, Waterproof, 5MP 1080P (Full-HD).

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën F ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

- webcam me fokusim automatik

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk ka dorëzuar fare oferte për kërkesën G.

Provë:
Kërkesa G në Specifikimet Teknike të Detyrueshme:

G) UPS 1000 wat - Duhet të jetë i vendosur në brendi të e-Kioskut - një copë.

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën G ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

• Furnizim me energji elektrike 500W,
• Mbrojtja (Overload protection) – me 5 priza 16 A 250 V ~ 3500 W me mbrojtje

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit për kërkesën H, konkretisht kërkesën për: llamarine s'paku prej 4mm ne pjesën e përparme dhe se paku 2mm ne pjesën anësore.

Prove:
Kërkesa H ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

H) Pjesa e jashtme e-Kioskut duhet të jetë e përshtatur me ambientin e jashtëm dhe e përbërë nga llamarina s'paku prej 4mm në pjesën e përparme dhe së paku 2mm në pjesën anësore. Gjatë fazës së ofertimit, OE duhet të dorëzojë të paktën 1

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën H ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

- Kabina të jetë moderne me dizajn modular metalik nga çeliku me trashësi minimale prej 1.5 mm e deri në 2.0 mm Anti-vandal Kabinë,

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i permbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit për kërkesën H, konkretisht kërkesën për: Gjate fazës se ofertimit, OE duhet te dorëzojë te paktën 1 mock-ups te detajuar me dimensione te e-Kioskut.

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk ka dorëzuar fare oferte për kërkesën: Pajisja duhet te posedoje izolim me qellim te amortizimit te ndryshimeve te temperaturës, si dhe te posedoje pajisje ventiluese me temostat, ne mënyrë qe te aktivizohet mbi temperaturën 30°.Pajisja duhet te posedoj izolim me qellim te amortizimit te ndryshimeve te temperaturës, si dhe te posedoje pajisje ventiluese me termostat, ne mënyrë qe te aktivizohet mbi temperaturën 30°.

Provë:
Kërkesa H ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:

H) Pjesa e jashtme e-Kioskut duhet të jetë e përshtatur me ambientin e jashtëm dhe e përbërë nga llamarina s'paku prej 4mm në pjesën e përparme dhe së paku 2mm në pjesën anësore. Gjatë fazës së ofertimit, OE duhet të dorëzojë të paktën 1 mock-ups të detajuar me dimensione të e-Kioskut. Po ashtu, OE duhet të dëshmojë përmes fotografive implementimin e të paktën 3 e-Kioskave në ambientet të jashtëm dhe të shkruajë AK ku janë implementuar. Pajisja duhet të posedojë izolim me qëllim të amortizimit të ndryshimeve të temperaturës, si dhe të posedojë pajisje ventiluese me termostat, ne mënyrë qe te aktivizohet mbi temperaturën 30°.Pajisja

duhet te posedoj izolim me qëllim të amortizimit të ndryshimeve të temperaturës, si dhe të posedojë pajisje ventiluese me termostat, në mënyrë që të aktivizohet mbi temperaturën 30°.

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën H ne Specifikimet Teknike te Detyrueshme:
* Kabina të jetë moderne me dizajn modular metalik nga çeliku me trashësi minimale prej 1.5 mm e deri në 2.0 mm Anti-vandal Kabinë,
* Konstrukti i kabinës i thyer me dy dyer
* Dera e epërme - për qasje në paisjet elektronikë,
* Dera e poshtme - për qasje për plotësimin e letrave
* Interface board për sensorë dhe led dioda te webcam
* Anti sistemi i vjedhjes i paisur me 4 pika mbylljeje të sigurisë, i cili nuk lejon qasje të paautorizuar në komponente brenda pajisjeve dhe siguron rezistencën ndaj vandalizmit
* Kabina e parashikuar për 24-orë përdorim të përditshëm me një hapësirë të veçantë për pajisjet elektronike
* Qasja në servisim të paisjeve nga pjesa e perparme
* Panelet e përparme (2 të tilla) të jene të zëvendësueshme dhe të mundësojnë vendosjen e paneleve më të avancuara. * Të dhënat për elektrikë: 230 V / 50Hz,
* Ftohësit 80x80x25 mm - 3 copë
* Ndërprerësi ON / OFF me çelës

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderi, konkretisht kërkesën për: specifikacioni i Softuerit dhe Shërbimeve për E-Kiosku.

Prove:
Kërkesa 2 për specifikiacioni i Softuerit dhe Shërbimeve për E-Kiosku:

2.SPECIFIKACIONI I SOFTUERIT DHE SHËRBIMEVE PËR E-KIOSKUN
Përshkrimi i artikullit
Softueri dhe shërbimet për e-Kioskun me karasteristikat e mëposhtme: 2.1 Platforma softuerike duhet të hartohet në gjuhën serbe, shqipe dhe angleze. 2.2 Softueri për aplikim duhet të jetë modular dhe të mundësojë lëshimin e: 1. Certifikatës së lindjes 2. Ekstraktit nga regjistri qendror 3. Certifikatës së martesës 4. Certifikatës së shtetësisë 5. Certifikatës së vendbanimit 6. Certifikatës së prones (fletës poseduese) 2.3 Softueri për certifikatën e pronës (fletën poseduese), duhet të ndërlidhet me sistemin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Kjo do të kryhet nga ana e operatorit ekonomik.

2.4 E-kiosku duhet të ofrojë mundësinë edhe të shërbimeve të tjera si:
• Paraqitja e informatave në lidhje me faturën e tatimit në pronë (opcionale printimi).
2.5 Softueri duhet të mundësojë ndërlidhjen me sistemin qendror të të dhënave të regjistrit civil. Kjo do të kryhet nga ana e operatorit ekonomik i cili është po ashtu i obliguar që gjatë ofertimit të përshkruajë edhe mënyrën se si do e realizojë. Agjancia për Regjistrimin Civil (ARC) e siguron web shërbimin.
2.6 Sistemi duhet të ruajë të dhënat e aplikuesit në data bazën lokale dhe qendrore të ARC. Operatori ekonomik me rastin e ofertimit duhet ta përshkruajë realizimin e ruajtjes lokale të të dhënave, pasi qe ruajtja e të dhënave në ARC bëhet përmes web shërbimit.
2.7 Sistemi duhet të ofrojë raporte të ndryshme përfshirë raportet ditore, javore dhe mujore.
2.8 E-Kiosku duhet të ofrojë komunikim me pajisjet periferike dhe po ashtu për këtë Operatori ekonomik me rastin e ofertimit duhet ta përshkruajë realizimin.
2.9 Sistemi duhet të ketë modulin për autentifikim dhe autorizim përmes letërnjoftimit.
2.10 Databaza duhet të jetë në MS SQL.
2.11 Mora imati instaliran licencirani operativni sistem i antivirus.
2.12 E-Kiosku duhet të jetë në gjendje të pranojë kërkesën, të pranojë pagesën dhe të shtyp certifikatën dhe dëshminë e ndërkaq të dhënat të merrën në kohë reale nga sistemi i gjendjes civile dhe nga sistemi i Departamentit të Tatimit në Pronë në MF.
2.13 E-Kiosku duhet të ruajë të dhënat në server për secilin qytetar që i shfrytëzon shërbimet e E-Kioskut.
2.14 Të dhënat e qytetareve gjatë aplikimeve duhet të kenë mundësinë të lexohen përmes një softueri te veçantë qe do instalohet në lokacionet e përcaktuara nga komuna. Ky softuer duhet të zhvillohet nga kompania fituese dhe duhet të paraqesë: të dhënat e LOG-ut, ketë mundësinë e filtrimit, ketë mundësinë e printimit dhe eksportimit ne formatin excel.
2.15 Pranuesi i monedhave duhet të pranojë monedhat si në vijim: 0.10 euro, 0.20 euro, 0.50 euro, 1.00 euro dhe 2.00 euro.
2.16 Duhet të detektojë monedhat e dëmtuara, falsifikatet dhe të kthejë kusurin. Duhet të jetë i mbyllur me çelës special dhe të ketë mundësinë e hapjes vetëm nga personat e autorizuar.
2.17 Përdorimi i e-Kioskut duhet të ofrohet përmes ekranit të ndjeshëm në prekje me madhësi së paku 17inch.
2.18 Sistemi aplikativ i çertifikatave duhet të ketë të instaluar sistemin aplikativ, të bazuar në ikona dhe me udhëzues për secilin veprim, në mënyrë që të mundësojë shërbimin e kërkuar nga qytetarët. Sistemi duhet të jetë i ndërlidhur me sistemin e gjendjes civile në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe sistemet tjera institucionale të domosdoshme për shërbimet e ofruara dhe duhet të merr të dhënat në kohë reale, sapo qytetari të ketë kërkuar llojin e certifikatës. Përmes e-Kioskut duhet të ofrohen të gjitha llojet e dokumenteve që ofron Sektori i Gjendjes Civile përmes web shërbimeve (dokumentet e cekura më lart).
2.18 Monitorimi i sistemit aplikativ - I gjithë sistemi duhet të ketë sistemin monitorues, i cili mundëson qasje specifike për administratorin e tyre, nga ku ai duhet të merr informacionet relevante mbi funksionueshmerinë e pajisjës dhe sasisë së dokumenteve në gjendje për t'u shtypur.
2.18 Hapja e e-Kioskut duhet të bëhet përmes dy çelësave që nuk duhet të jenë në miniaturë.
2.18 E-Kiosku duhet të ketë çelës shtesë për monedha, i cili nuk duhet të jetë në miniaturë.
2.19 E-kiosku duhet të ketë mundësinë e zgjerimit te shërbimeve në të ardhmen.

Oferta nga OE i rekomanduar për kontrate për kërkesën 2 specifikiacioni i Softuerit dhe Shërbimeve për E-Kiosku:
Vërejtje:

1. Softueri për aplikim është i përgatitur në gjuhët zyrtare të Kosovës(Shqip, Serbisht, Anglisht)
2. Softueri ruan te dhëna ne bazën lokale dhe ne bazën e qendrore ne Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit. Kërkohet që operatori ekonomik te paraqes planin teknik te realizimit te këtij funksionaliteti.
3. Softueri është ndërtuar ashtu që të nxirren raporte te ndryshme për nevoja te komunës
4. Softueri duhet të përmbajë edhe modulet për autentifikim dhe autorizim
5. Baza e të dhënave duhet të jetë MS SQL.

- AK gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar si te përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk ka dorëzuar oferte e as deklaratë se do te përfundoj punët për Prerja dhe largimi i profilit te aluminit dhe gjamave ne pjesën ballore ku do te vendoset e-Kiosku, si dhe sjellja dhe montimi i gjamave dhe profileve te aluminit për mbylljen e pjesëve anësore te hapësirave.

Provë:
Kërkesa 3 pre specifikimi i punimeve pre montimin dhe vendosjen e E-Kioskut ne ndërtesën e Komunës.

3.SPECIFIKIMI I PUNIMEVE PËR MONTIMIN DHE VENDOSJEN E E-KIOSKUT NË NDËRTESËN E KOMUNËS
Përshkrimi i artikullit
Specifikimi i punimeve për montim: 3.1 Prerja dhe largimi i profilit të aluminit dhe gjamave në pjesën ballore ku do të vendoset e-Kiosku, si dhe sjellja dhe montimi i gjamave dhe profileve të aluminit për mbylljen e pjesëve anësore të hapësirave.

- AK. gjate vlerësimit te ofertave ka vlerësuar site përgjegjshme ofertën e OE te përzgjedhur për kontrate edhe pse i njëjti nuk i përmbushë kërkesat minimale te dosjes se tenderit, konkretisht kërkesës për deklarate pre specifikacionet teknike pre mallrat e ofruara te cilat përputhen me ato te përmendura ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Provë:
Kërkesa e AK ne FTD, neni 3.1:

3. Specifikimet teknike të detyrueshme	3.1 Furnizimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, shih Aneksin 1, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasitë, modelet mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera. Kjo do të demonstrohet me dorëzimin e provave të dokumentuara të përcaktuara në FDT. 3.2 Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin.

Andaj - me këtë rast - kërkojmë nga OSHP qe te Aprovoje ankesën e OE ankues dhe ta obligoje AK - Komunën e Graçanicës, qe për shkak te shkeljeve te cekura me larte, këtë Aktivitet te Prokurimit ta kthej ne Rivlerësim.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta me pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Bazuar në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderit, , bazuar në vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Nr. 709/20 dhe në bazë të kritereve për dhënie të kontratës: Tenderi me çmimin më të ulët, ne si komision vlerësues rekomandojmë që OE "DLD Group" SH.PK, Perandori Justininan nr. 25, 10000, Prishtinë, të shpallet fitues në vlerë të kontratës prej 13,850,00 €.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Me datë 19.11.2020 është kërkuar informacion shtesë përmes emailit nga AK dhe në të njëjtën ditë AK është përgjigjur me email duke dhënë sqarime.

Poashtu me datë 19.11.2020 është kërkuar informacion shtesë edhe nga OE ankues dhe me datë 20.11.2020 kemi pranu sqarimet nga OE ankues.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "PBC" SH.P.K - PRISHTINË

Sqarim hyrës: Ky aktivitet i prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP dhe se paneli shqyrtues lidhur me këtë aktivitet ka nxjerrë vendimin me numër 709/20.

Pretendimet ankimor të OE ankues sipas kësaj ankese kanë të bëjë me vendimin e AK-së për shpërblim me kontratë OE "DLD GROUP" Sh.P.K.

OE ankues ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me datë 02.11.2020. Përderisa, AK me datë 03.11.2020, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim pa dhënë sqarime konkrete për shqyrtimin e pretendimeve ankimore, por ka theksuar se AK ka vepruar sipas vendimit të OSHP-së 709/20.

<u>Përgjigje në Pretendimin Ankimor 1</u> - OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushë specifikat teknike të dosjes së tenderit.

Në dosjen e tenderit, Aneksi 1-Specifikimet teknike të detyrueshme, AK në tri pika ka kërkuar që OE të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit gjatë ofertimit të ofrojnë dëshmi apo përshkrime për përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit.

Fillimisht, për pozicionin 1, është përshkruar kërkesa H si vijon: "*.....Gjatë fazës së ofertimit, OE duhet të dorëzojë të paktën 1 mock-ups të detajuar me dimensione të e-Kioskut. Po ashtu, OE duhet të dëshmojë përmes fotografive implementimin e të paktën 3 e-Kioskave në ambientet të jashtëm dhe të shkruajë AK ku janë implementuar. .....*"

Në tenderit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë është dorëzuar edhe dokumenti "15.KIOSKA". Në këtë dokument janë paraqitur tri imazhe ilustruese për e-kioskun. Megjithatë në këtë dokument nuk janë ofruar informata për dimensionet ashtu sikurse është kërkuar. Ndërsa, lidhur me dëshmitë për implementimin e 3 e-Kioskave në ambientet të jashtëm dhe informacionet e AK-ve se ku janë implementuar, OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave nuk ka paraqit imazhe, mirëpo OE ankues ka dorëzuar një broshurë të komunës së Prishtinës për e-kioskun e vendosur në Komunën e Prishtinës.

Më tej, në pozicionin 2, pika 2.5 AK ka kërkuar që "*..... OE i cili është po ashtu i obliguar që gjatë ofertimit të përshkruajë edhe mënyrën se si do e realizojë.*" OE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar dëshmi se si do ta realizojë lidhjen e softuerit të e-kioskut me bazën e të dhënave të Regjistrit Qendror Civil të ARC-së.

Në fund, poashtu për pozicionin 2, pika 2.8 AK ka kërkuar që "*....E-Kiosku duhet të ofrojë komunikim me pajisjet periferike dhe po ashtu për këtë Operatori ekonomik me rastin e ofertimit duhet ta përshkruajë realizimin.*"

Edhe për këtë pikë OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar përshkrimin apo zgjidhjen për këtë kërkesë.

Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, për shkak se nuk janë dhënë dimensionet e e-kioskut, nuk ka dëshmi për e-kiosqe që janë implementuar me informatat e AK-ve, nuk ka ofruar përshkrimin se si do ta realizojë lidhjen e softuerit me bazën qendrore të të dhënave të ARC-së dhe nuk ka ofruar modalitet për relizimin e komunikimit sipas pikës 2.8, rrjedhimisht pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin Ankimor 2- OE ankues gjithashtu pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbushën specifikimet teknike të dosjes së tenderit në disa pozicione tjera sipas broshurës së dorëzuar.
AK përmes e-mailit me datë 19.11.2020 ka sqaruar se gjatë fazës së rivlerësimit nuk ka kërkuar informacione shtesë, mirëpo i referohet broshurës së dorëzuar së bashku ankesën 709/20 nga OE "DLD Group" dhe thekson se OSHP e ka marrë për bazë këtë dokument gjatë shqyrtimit të ankesës 709/20. Vlen të theksohet se as në Raportin e Ekspertizës dhe as në Vendimin e Panelit Shqyrtues një dokument i tillë nuk është marrë për bazë gjatë shqyrtimit të ankesës 709/20.
Në lidhje me mospërmbushjen e specifikimeve teknike të dosjes së tenderit sipas modelit të ofruar në broshurën e bashkangjitur me ankesë, ritheksojmë se ashtu sikurse është sqaruar në raportin paraprak që lidhet me ankesën 709/20 një dokument i tillë nuk është kërkesë e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Andaj, konsiderojnë se ky pretendim ankimor është trajtuar në raportin paraprak dhe vendimin e Panelit Shqyrtues dhe ri-shqyrtimi i pretendimit të njëjtë ankimor është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së OSHP-së 01/2020, përkatësisht nenin 16, paragrafi 2. Në të njëjtën kohë njoftohet Paneli Shqyrtues se ky pretendim është trajtuar e për të cilin është vendosur sipas vendimit numër 709/20, të datës 27.10.2020.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Kuvendi Komunal Graçanicë
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - "PBC" Sh.P.K